Kronikë

Iu gjet kokainë dhe municioni luftarak në makinë, arrestohen dy persona në Tiranë

Dy persona janë vënë në pranga nga Policia e Tiranës, pasi gjatë një kontrolli të mjetit të tyre u gjetën kokainë dhe municion luftarak, të cilat u sekuestruan nën cilësinë e provës materiale.

Foto ilustruese

Redaksia
13 Korrik, 10:39 | **Përditesimi: 13 Korrik, 10:41**

Dy persona janë vënë në pranga nga Policia e Tiranës, pasi gjatë një kontrolli të mjetit të tyre u gjetën kokainë dhe municion luftarak, të cilat u sekuestruan nën cilësinë e provës materiale.

Njoftimi i policisë:

LEXO EDHE:
Tragjedia në plazhin Vilë-Bashtovë, dëshmia e administratorit në gjykatë: Edhe 10 vrojtues të ishin nuk do bënin dot gjë! Gjykata e lë në 'arrest shtëpie'

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve arrestuan shtetasit S. K., 48 vjeç dhe S. B., 39 vjeç, banues në Vlorë, pasi gjatë kontrollit fizik, shërbimet e Policisë iu gjetën sasi lënde të dyshuara narkotike kokainë, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, bashkë me një sasi të vogël municioni luftarak që u gjet gjatë kontrollit në automjetin me të cilin ata qarkullonin.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 1 arrestuan shtetasin Sh. K., 30 vjeç, banues në Tiranë, pasi ka përndjekur dhe kanosur ish-të dashurën e tij, për një periudhë 1-vjeçare.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 4 arrestuan shtetasit:

- M. Sh., S. Sh. dhe A. Sh., të tre banues në Tiranë. Shtetasi M. Sh. dhe shtetasja S. Sh. kanë ushtruar dhunë ndaj bashkëshortes së djalit të tyre, shtetasit S. Sh., ndërsa ky i fundit e ka goditur bashkëshorten e tij, me send të fortë;

- L. A., 40 vjeç, banuese në Tiranë, pasi ka ushtruar dhunë ndaj bashkëjetueses së tij.

Gjithashtu, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 4 ndaluan shtetasin F. F., 66 vjeç, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj bashkëjetueses së tij.

Specialistët e Qarkullimit Rrugor arrestuan shtetasit:

- O. M., 49 vjeç, banues në Tiranë dhe K. M., 31 vjeç, banues në Thumanë, pasi duke drejtuar automjetet përkatëse, në gjendje të dehur, janë përplasur me dy automjete të tjera, me pasoja vetëm dëme materiale.

Në Komisariatin e Policisë Nr. 3 është paraqitur shtetasi M. V., 33 vjeç, banues në Tiranë, i cili ka kallëzuar se është larguar nga banesa bashkëshortja e tij, shtetasja Xh. V., 30 vjeçe. Punohet për gjetjen e saj.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme procedurale.

M.T/Shqiptarja.com

TAG: Tirane Dhune kokaine

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Ahmetaj drejt arrestimit, a po e lufton SPAK korrupsionin?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Harmonia mes dy vendeve, në Tiranë kostumet shekullore malazeze! Çullafiq: Në kohën e Krajl Nikollës kushtonin sa një shtëpi! Amaneti i të parëve për to

Anila Dedaj

12 Korrik, 16:17

Gjermania me më shumë raste të raportuara të dhunës në çift

12 Korrik, 13:30

Shpërndante kokainë dhe kanabis në lokalet e natës, arrestohet 20-vjeçari në Himarë

12 Korrik, 11:33

Durrës/Kreu veprime të turpshme ndaj vajzës së bashkëjetueses së tij, në pranga 38-vjeçari i shpallur në kërkim

12 Korrik, 11:22

Vidhte mjete pune në biznese të ndryshme në Kamëz, vihet në pranga 31-vjeçari

12 Korrik, 09:12

Tiranë, shurdhmemeci dhunon gruan me sende të forta, 47 vjeçarja përfundon në spital! Burri ikën

11 Korrik, 23:00

Babai me dy djemtë u mbytën në plazhin e Vilë-Bashtovës, gruaja dhe vajza e tij në kushte të vështira ekonomike, hapet llogari në GOFUNDME

11 Korrik, 13:45

E arrestuar për pastrim parash dhe fshehje pasurie, Klosi sërish kërkesë në Gjykatën e Tiranës për ndryshim masë: Jam sëmurë, duhet të kujdesem për fëmijët! Shtyhet seanca

11 Korrik, 12:33

Shkolla 'Asim Vokshi' gati në vjeshtë, Veliaj: Dyfishuam kapacitetet për 750 nxënës! Turizmi në Tiranë, rritje të jashtëzakonshme

11 Korrik, 12:30

Hodhën silenciatorin me 3 fishekë sapo panë policinë arrestohen dy persona në Tiranë

11 Korrik, 12:14

FOTOT/Bashkia vijon ndërhyrjet në infrastrukturë, nis rehabilitimi i bllokut të banimit në Njësinë 4

11 Korrik, 11:40

Ishte dënuar për vrasje, arrestohet pas disa vitesh arrati 35-vjeçar shqiptar në Greqi! Policia aksion 3 ditor në Zakynthos, ja çfarë u zbulua

11 Korrik, 09:03

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Gerbutto

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje